



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202101494/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda :** *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Drejtorisë/Komisariatit të Policisë Korçë.*

**Drejtuar :** Kryekomisar Bujar LAZE  
Shefi i Komisariatit të Policisë në Korçë

**KORÇË**

**Për dëjoni:** Drejtues i Lartë Gjovalin LOKA  
Drejtor i DVP në Korçë

**KORÇË**

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në datën 11.11.2021 në ambientet e privimit të lirisë së personit në DVP dhe Komisariatit të Policisë Korçë.

Inspektimi u krye sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Gloria Çarkaxhiu, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm në datë 24.09.2019.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

## **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit të Policisë në Korçë, z.Bujar Laze dhe shefin e rendit z.Mariglen Jaçellari, të cilët u vunë në dijeni në lidhje me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesi i Komisarariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me respektimin dhe trajtimin e shtetasve gjatë qëndrimit të tyre në mjediset e Komisarariatit në cilësinë e të shoqëruarve dhe të ndaluarve/arrestuarve, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve ndërkombëtare për këtë qëllim, plotësimin e kushteve në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm të zhvilluar në datë 24.09.2019.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me përgjegjës të dhomave të sigurisë dhe punonjësit e zyrës së informacionit të dhomave të shoqërimit, inspektoi mjediset ku mbahen dhe trajtohen personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, verifikoi dhe administroi dokumentacionin që plotësohej prej punonjësve të policisë sipas procedurave standarde, vizitoi zyrat e specialistëve të policisë të këtij institucioni që kryejnë veprime procedurale me shtetasit e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, si dhe zhvilloi intervista konfidenciale me personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, në lidhje me respektimin e të drejtave dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të tyre.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe në zyrat e specialistëve të policisë të këtij institucioni.

Grupi i inspektimit, konstatoi se punonjësit e policisë të Komisarariatit, në zyrat e punës së tyre dhe gjatë kryerjes së shërbimit në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, zbatonin me korrektësi masat e protokollit shëndetësor anti COVID-19. Në këto ambiente ishin vendosur dizifektantë për pastrimin e duarve, si dhe maska mbrojtëse mbahej rregullisht nga personeli i shërbimit.

Lidhur me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar, rezultoi se:

1. Ishte plotësuar organika e DVP-së Korçë me mjek (me kohë të pjesëshme). Nga kqyrja e regjistrit, por dhe intervistat e zhvilluara me personat e ndaluar/arrestuar, u evidentua prania e mjekut në çdo kohë dhe kryerja e vizitave mjekësore brenda afatit 12 orë, nga koha e hyrjes të personave të ndaluar/arrestuar në dhomat e sigurisë.
2. Ishte plotësuar rekomandimi, për instalimin e sistemit të kamerave në dhomën e marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, e cila ndodhej në ambientin e sigurisë të këtij komisarati.

3. Ishte plotësuar rekomandimi, për mundësimin e kontaktit me avokatët mbrojtjes të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, si dhe evidentimin në regjistër të kohës në të cilën sigurohej një gjë e tillë.

Nga inspektimi, u evidentua se disa nga rekomandimet nuk ishin realizuar, dhe sipas informacionit të drejtuesve të Komisarariatit, shkakua ka qenë mungesa e fondeve për kryerjen e investimeve në këto ambiente, konkretisht:

1. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e një zyre më vete ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se ata të dërgohen në dhomat e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
2. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për instalimin në murin e brendshëm të dhomave të sigurisë, të butonit me zile/sinjali për kontaktin e këtyre personave me punonjësën e policisë në rast nevojë.

Në përfundim të vizitës inspektuese, grupi i monitorimit të MKPT-së u takua edhe me Drejtorin e DVP-së Korçë, z.Gjovalin Loka, me të cilin ndau dhe trajtoi disa nga gjetjet e grupit të inspektimit në komisarariatet e policisë Korçë, Ersekë, Devoll dhe Pogradec, që janë në varësi të kësaj drejtorie.

Vlen të theksojmë angazhimin e Drejtorit dhe strukturës të DVP-së Korçë, për bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve, si dhe gadishmërinë e tij për vënien në rrugën e zgjidhjes të problematikave që u evidentuan nga inspektimi i MKPT-së në strukturat e Policisë të Qarkut Korçë.

### **Ambienti i shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisarariatit e Policisë Korçë, ishte i ndërtuar përgjithsisht sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar dhe procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se: *“dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit”*.<sup>1</sup>

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së Komisarariatit dhe përbëhej nga 2 (dy) dhoma shoqërimi, të ndara për personat e rritur dhe për gra. Ndërsa, intervistimi i të miturve kryhej në ambientet e Njesisë për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje, i cili përbëhej nga 3 dhoma. Dhomat e këtij ambienti ishin të kompletuara me tavolina pune për punonjësit e policisë, psikologun, avokatin mbrojtës dhe përfaqësuesin ligjor, si dhe me orenditë e nevojshme kolltuk e karrige për qëndrimin komod dhe ulur të të miturve. Ky investim ishte kryer në kuadër të një programi bashkëpunimi midis DPPSH-së me organizatën *“Save the children”*.

---

<sup>1</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 4x5 m secila prej tyre, me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave, të kompletuara me orenditë e nevojshme si tavolina pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë, si dhe karrige me këmbë të fiksuara dhe të pa lëvizëshme, për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruarve. Kapaciteti për secilën dhomë ishte për mbajtjen dhe qëndrimin e 5(pesë) personave. Në total kapaciteti i dhomave të shoqërimit ishte për 10(dhjetë) persona.

Dhomat kishin dritare me xham, të siguruar në pjesën e jashtme me skarë hekuri. Përmasat e dritareve ishin të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, si dhe kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjeno-sanitare.

Në korridorin e këtij ambienti, ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin 2(dy) tualete të pajisura me nyje hidrosanitare, ato ishin të pastra nga ana higjenike, kishin ndriçim artificial dhe furnizoheshin rregullisht me ujë të rrjedhshëm.

Koridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera, për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me të shoqëruarit.

Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Ndërsa, për periudhën Janar–Nëntor 2021, ishin shoqëruar për në mjediset e këtij komisariati 1412 persona. Nga kqyrja e regjistrit të të shoqëruarve, nuk u konstatuan raste të mbipopullimit në dhomat e shoqërimit. Në korridorin e këtij ambienti ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Ndërsa në dhomat e shoqërimit **nuk** ishin të afishuar postera me të drejtat e të shoqëruarve. Në tërësi, posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, ishin të rinj dhe të përditësuar sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e ri të Procedurës Penale.

Nga inspektimi u evidentua se mungonte një dhome më vehte për marrjen në pyetje apo intervistimi e të shoqëruarve të rritur dhe gra. Nga informacioni i drejtuesve të Komisarariatit, marrja në pyetje e personave të shoqëruar kryhej në zyrat e specialistëve dhe ndihmës specialistëve të policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve proceduriale.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, mungesa e një dhome intervistimi më vete për personat e shoqëruar që dyshohen për kryerjen e një vepre penale ose janë në hetim, (para se të kalojnë në dhomat e sigurisë), e monitoruar me sistemin e kamerave, krijon mundësinë e kryerjes së veprimeve të paligjshme me këta shtetas nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të tyre.

Nga informacioni i punonjësit të policisë në zyrën e informacionit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e një kopje të procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit, nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. U evidentua gjithashtu se, për personat e shoqëruar mbahej edhe “Formulari i raportit të Shoqërimit ose

Ndalimit/Arrestimit”, nga punonjësi i policisë që kryente shoqërimin në mjediset e Komisarariatit, ku përcaktohet përveç të dhënave edhe shkaku i shoqërimit, koha e qëndrimit të personit në këto ambiente dhe pretendimet e të shoqëruarit në lidhje me trajtimin nga punonjësi i policisë.

Grupi i inspektimit konstatoi se, në zyrën e informacionit ishte hapur më vete regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar të mitur dhe për periudhën e inspektimit ishin regjistruar të dhënat për 11 persona.

Nga intervistimi i punonjësve të policisë, në Komisariatin e Policisë Korçë letra me të drejtat e personave të shoqëruar **nuk** ju jepej shtetasve që në momentin kur atyre ju privohet liria, pra në orën e hyrjes në mjediset e Komisarariatit.

Kjo praktikë nuk është në përputhje me të drejtën për informim që gëzojnë shtetasit e shoqëruar në momentin e parë të shoqërimit. Ndaj ajo duhet të ndryshojë, referuar rekomandimeve të Avokatit të Popullit, por edhe raportit me rekomandime të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT-së), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20-30 Nëntor 2018<sup>2</sup>, ku thuhet shprehimisht se, shtetasit që shoqërohen në mjediset e Policisë të Shtetit duhet **“të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria...”**.

#### **Ambienti i sigurisë, kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve.**

Në Komisariatin e Policisë Korçë dhomat e sigurisë ishin të ndërtuara sipas kërkesave të parashikuara në procedurën standarde *“Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambienti i sigurisë përbëhej nga 6 (gjashtë) dhoma sigurie, me kapacitet për 6 (gjashtë) persona. Ato ishin të ndara 4 (katër) dhoma për personat e rritur, 1(një) për gra dhe 1(një) për të mitur.

Dhomat e sigurisë janë të ndërtuara sipas parametrave teknik të përcaktuar në procedurën standarde, të ndara në dy ambiente me një skarë hekuri dhe derë, në ambientin për fjetje dhe në paradhomë. Nisur nga hapësira dhe sipërfaqja e secilës dhomë, ato plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, ambienti i qëndrimi me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhoma me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).

<sup>3</sup> Kreu VIII, pika 3.3.3 e Procedurës standarde *“Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Çdo dhomë ishte e pajisuar me një krevat metalik me këmbë të palëvizëshme dhe ishin të kompletuar me dyshek, batanie dhe jastek, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe brenda afatit të përdorimit. Në ambientin e qëndrimit ndodhej dhe tualeti, ndërsa në paradhomë ndodhej një lavaman me çezëm që kishte ujë të rrjedhshëm, e cila përdorej për pastrimin vetjak.

Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e depërtimit të ajrit dhe dritës natyrale. Ato furnizoheshin me energji elektrike nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje, kishte gjenerator si burim alternativ.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larjen e trupit në një ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej brenda korridorit, në ambientin e sigurisë.

Dhomat e sigurisë ngroheshin nga çillerat që lidheshin me sistemin qendror të ngrohjes me kaldajë gjatë periudhës së dimrit, sikurse parashikohet në procedurën standarde: *“Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Në korridorin e ambientit të sigurisë, kishte aparat telefoni fiks për të mundësuar lidhjen e punonjësit të shërbimit në dhomat e sigurisë me sallën operative të Komisarariatit, në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, si dhe për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ndërsa, në dhomat e sigurisë **nuk** kishte buton zile/sinjali të montuara në mur për kontaktin e të arrestuarve/ndaluarve, me punonjës të policisë në rast nevojë.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma e mjekut, e cila shërben për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar, ruajtjen e dokumentacionit që mbahet prej tij, si dhe mbajtjen e medikamenteve të nevojshme për rastet e urgjencave. Kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit/arrestuarit paraqitet e përkeqësuar, me rekomandimin e mjekut, personi shoqërohet menjëherë për në Spitalin Rajonal të Korçës.

Dhoma ishte e pajisur me shtrat për kryerjen e vizitave mjekësore, tavolinë pune, karrige dhe një raft prej druri i mbyllur me bravë për mbajtjen e regjistrave dhe të barnave mjekësore. Ngrohja e ambientit realizohej me ngrohje qendrore.

Brenda ambientit të sigurisë ndodhej edhe dhoma për marrjen në pyetje të ndaluar/arrestuarve nga prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takimin e këtyre personave me avokatët mbrojtës, e cila ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige me këmbë të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme për qëndrimin ulur të personave, të cilat ofrojnë kushte pune për përfaqësuesit e organit të akuzës, si dhe për avokatin mbrojtës të tyre.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me 3 kamera, përgjatë 24 orëve. Kamerat administroheshin nga punonjësi i IT-së në DVP Korçë dhe afati i ruajtjes së pamjeve filmike ishte për 30 ditë.

Nga informacioni i punonjësve të policisë dhe intervistat e zhvilluara me personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr.189, datë 15.03.2017 *“Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”*. Atyre ju sigurohej 3 vakte ushqim në ditë, i cili përgatitej nga një subjekt privat sipas kontratës së lidhur me DVP Korçë dhe servirej me shërbim katering.

Në ambientin e sigurisë të Komisarariatit nuk kishte ambiente kulti më vete, por të ndaluarve/arrestuarve ju lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga intervistat me personat e arrestuar rezultoi se, ju jepeshin produkte për mbajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjentë, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Në momentin e inspektimit, në ambientin e sigurisë ndodheshin 5(pesë) persona të arrestuar, nga të cilat 4 ishin në moshë madhore dhe 1 grua. Grupi i inspektimit intervistoi personat e arrestuar, të cilët konfirmuan se, ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Për periudhën Janar – Nëntor 2021 ishin mbajtur në dhomat e sigurisë në cilësinë e personave të arrestuar dhe të ndaluar, gjithsej 596 persona, nga të cilët 25 ishin gra dhe 11 të mitur. Nga kqyrja e regjistrit, nuk u konstatua asnjë rast mbipopullimi në dhomat e sigurisë.

Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasojë të shkaktuara nga keqtrajtimi.

Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet proceduriale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre, duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të urdhër ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe letrës për njohje me të drejtat e tyre.

Nga informacionet e vizitës inspektuese, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Sipas parashikimeve në dispozitat e ligjit nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, si dhe Procedurën standarde *“Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në*

*ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 dhe në Procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, çdo njësi policore ku ka dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie, duhet të jetë e pajisur me regjistrat përkatës.

Theksojmë se, nga verifikimi i regjistrave dhe librave të shërbimit në Komisariatin e Policisë Korçë, u evidentua se dokumentacioni mbahej në rregull, regjistrat ishin të plotësuar sipas rubrikave, si dhe të sekretuar dhe vulosur, sikurse përcaktohen në modelet tip të miratuar në procedurat standarde.

Konkretisht, në zyrën e informacionit ndodhej “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” sipas tipit “Model nr.1”, konform me procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por në çdo rast brenda afatit deri në 10 orë. Ndërsa në rastet e mbajtjes së personit nën hetim afati kohor shkonte deri në 12 orë. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>4</sup>.

Në këtë komisarjat mbahej dhe regjistri me të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili gjithashtu ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë njëherësh për komisarjatet e Korçës, Pogradecit, Ersekës dhe Devollit, në varësi të DVP Korçë. Në proces verbalin e arrestimit apo ndalimit, ishte shënuar ora kur personat ishin mbajtur të shoqëruar në mjediset e policisë, pra në momentin kur atyre ju ishte privuar liria.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në këtë Komisarjat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Nga kontrolli rezultoi se ishin evidentuar vetëm 2 kërkesa për vitin 2021, me objekt kërkesë për avokat mbrojtës, dhe sipas shënimeve në regjistër ishin të plotësuara.

---

<sup>4</sup> *Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*



## **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë Korçë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në zyrat e punës së tyre, pasi mungonte një ambient i veçantë për intervistimin e tyre. Këto zyra, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Avokati i Popullit nisur nga konstatimet edhe në inspektimet e mëparëshme, ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore (për personat e dyshuar për kryerjen e një vepre penale) dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por grupi i inspektimit konstatoi se, ky rekomandim sërish nuk ishte plotësuar<sup>5</sup>.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga inspektimi i zyrave të punonjësve të policisë të këtij komisarlati, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

## **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në Komisarlatin e Policisë Korçë, zbatohet detyrimi për të njoftuar avokatët mbrojtës pa pagesë, për personat e ndaluar/arrestuar që nuk kanë mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë. Në çdo rast, në regjistër ishte i evidentuar emëri i avokatit mbrojtës, personi i ndaluar/arrestuar me të cilin ishte takuar, si dhe oraret e takimit që nga momenti i ndalimit të këtyre personave në mjediset e këtij Komisarlati.

Në rastet e të miturve të shoqëruar në mjediset e Komisarlatit, asistohet nga psikologu që ishte në strukturën organike të DVP Korçë, punonjësit e policisë të trajnuar për të miturit dhe kundër dhunës në familje, avokati mbrojtës dhe kujdestari ligjor.

Në momentin e inspektimit, nga intervistat me personat e ndaluar/arrestuar, rezultoi se, ata ishin të pajisur me kopje të urdhërit të ndalimit/arrestimit, letrën e të drejtave, si dhe ishin të njohur me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij, në zbatim të kërkesave të parashikuara në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale.

---

<sup>5</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”  
Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

Për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, ishin përgatitur letra me të drejtat e të ndaluar/arrestuarve në 6-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht dhe gjuhën rome.

Nga intervistat e zhvilluara nga grupi i inspektimit, zbatohet drejta për njoftimin e familjarëve të personave të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë, sikurse parashikohet në nenin 34/b pika 1/c të Kodit të Procedurës Penale. U konstatua gjithashtu se, në regjistër ishte evidentuar dhe emëri i personit familjar apo të afërm të njoftuar që lidheshin me personat e shoqëruar në mjediset e policisë, si dhe ora e njoftimit të tyre me telefon, sipas rubrikave në regjistër.

Grupi i inspektimit konstatoi se, vizita mjekësore nga ana e mjekut (me kontratë me kohë të pjesëshme) kryhet rregullisht brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurën standarde, si dhe mjeku ishte prezent sa herë kërkohet nga personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluar/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në kartelat ditore dhe regjistrin e vizitave mjekësore. Në rastet e urgjencave, me rekomandimin e mjekut të sëmurët shoqëroheshin menjëherë në Spitalin Rajonal të Korçës.

Nga kontrolli i dosjeve mjekësore të shtetasve të ndaluar/arrestuar, rezultoi se, ishin hapur kartelat mjekësore (*kartelat ditore*) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për secilin prej tyre.

Në Komisariatit e Policisë Korçë, zyra për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurorët, që ndodhet në ambientin e sigurisë, ishte e monitoruar me kamera.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e mjedist të shoqërimit dhe të sigurisë të Komisariatit, ishin të afishuara postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, si dhe nenit 81, pika 2/b të ligjit 81/2020 ku përcaktohet se Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca: “*paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues*”:

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrës (dhomës) ku merren në pyetje personat e shoqëruar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë, e cila duhet të jetë e kopletuar me orënditë e nevojshme dhe e pajisur me sistemin e kamerave.
2. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin në dhomat e sigurisë, të butonit me zile/sinjalit, për kontaktin e personave të ndaluar/arrestuar me punonjësin e policisë të shërbimit, në rast nevojë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e personave të shoqëruar me letrën e të drejtave të tyre, që në momentin e privimit të lirisë, në orën kur ata hyjnë në mjediset e Komisarariatit.
4. Organizimin e trajnimit të punonjësve të policisë të Komisarariatit, në veçanti atyre që kryejnë shërbimin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e sigurisë, për ti njohur me rekomandimet e CPT-së lidhur me kushtet që duhet tu garantohen dhe trajtimin sipas standardeve të personave që mbahen, qëndrojnë dhe sigurohen në mjediset e Policisë së Shtetit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**